UNIVERSITETI®
METROPOLITAN
TIRANA

# PLANI I PUNËS I ZYRËS SË CILËSISË (NJSBC)

## Viti Akademik 2025–2026

## I. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

### Objektivi i Brendshëm

Garantimi i cilësisë së mësimdhënies dhe funksionimit të brendshëm në mënyrë të vazhdueshme, të matshme dhe të koordinuar.
Kjo përfshin:

- funksionim real të institucionit deri në përfundim të orarit (deri në orën 21:00),
- kushte më të mira pune për pedagogët,
- sqarim rolesh dhe përgjegjësish në akreditim,
- vlerësim sistematik të studentëve dhe proceseve,
- bazë të dhënash institucionale që shmang konfuzionin.

### Objektivi i Jashtëm

Rritja e performancës së UMT në raport me ASCAL, agjencitë ndërkombëtare dhe tregun, duke garantuar dokumentacion, raporte dhe praktika të krahasueshme me standardet ENQA/EUA.

## II. PARIMET E PUNËS SË NJSBC

- Transparencë në të gjitha proceset akademike dhe administrative.
- Evidencë dhe prova për çdo vendim, raport apo proces.
- Matshmëri (KPI) për çdo aktivitet.
- Koordinim i qartë me Fakultetet, Departamentet, Rektoratin.
- Cikël vjetor PBKV (Planifiko–Bëj–Kontrollo–Vepro).

## III. PLANI VJETOR I PUNËS PER NJSBC

*(I strukturuar sipas ciklit akademik)*

UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA REKTORI

## A. PERIUDHA SHTATOR – DHJETOR

1. Rishikimi dhe miratimi i programeve të studimit & ngarkesës mësimore

Përgjegjës: Fakultetet, Departamentet, NJSBC, Senati Akademik
Afati: Shtator
KPI: Vendim Senati + databaza e programeve të reja.

**2. Informimi i studentëve për të drejtat dhe detyrimet**

Përgjegjës: NJSBC, Fakultetet, Departamentet, Dekani i Studentëve
Afati: Tetor–Nëntor
Mënyra: Përmbledhje e Statutit dhe Rregullores në format elektronik + prezantime dhe takime në auditor
KPI: ≥ 80% pjesëmarrje e studentëve.

**3. Sesione informuese për stafin mbi standardet e cilësisë**

Përgjegjës: NJSBC, Dekanatet
Afati: Nëntor
KPI: 1 prezantim/Departament + manual cilësie për pedagogët.

**4. Harmonizimi i roleve në proceset e akreditimit**

**Përgjegjës:** NJSBC, Rektorati, Dekanatet
**Afati:** Nëntor
**Prodhim:** Dokument "Procedurat e brendshme të akreditimit"
**KPI:** Rritje e efikasitetit në përgatitjen e raporteve.

**5. Vlerësimi i cilësisë së studentëve të vitit të parë**

Përgjegjës: NJSBC, Rektorati, Sekretaria Mësimore
Afati: Dhjetor
KPI: Raport me propozime për përmirësim + rekomandime për ndërhyrje (p.sh. Matematikë Zero).

## B. PERIUDHA JANAR – MARS

**6. Zhvillimi dhe administrimi i anketimit semestral**

Përgjegjës: NJSBC, Fakultetet
Afati: Janar – Shkurt
KPI: ≥ 60% pjesëmarrje studentore.

**7. Përpunimi, diskutimi dhe raportimi i rezultateve**

Përgjegjës: NJSBC, Dekanatet, Departamentet
Afati: Shkurt

Prodhim: Raport + Plan Veprimi Fakultetesh
KPI: Zbatimi i rekomandimeve deri në fund të semestrit.

UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA REKTORI

**8. Monitorimi i provimeve të dimrit**

Përgjegjës: NJSBC, Dekanatet
Afati: Janar – Shkurt
KPI: Raport i verifikimit të integritetit të provimeve.

## C. PERIUDHA PRILL – KORRIK

**9. Rishikim cilësor i syllabusave & programeve**

Përgjegjës: Fakultetet, NJSBC
Afati: Prill
KPI: Syllabuset të përmirësuar realisht çdo vit.

**10. Analizë e aktivitetit të komunikimit dhe marrëdhënieve me jashtë**

Përgjegjës: NJSBC, Drejtoria e Komunikimit
Afati: Janar - Shkurt
KPI: Raport + rekomandime + auditim i prezencës së UMT.

**11. Anketimi semestral i dytë**

Përgjegjës: NJSBC, Fakultetet
Afati: Qershor
KPI: $\geq$ 60% pjesëmarrje e studentëve

**12. Përpunim dhe Raportim i rezultateve**

Afati: Qershor–Korrik
KPI: Raport + plan për përmirësim.

**13. Monitorimi i provimeve të verës**

Përgjegjës: NJSBC, Dekanatet
Afati: Qershor–Korrik
KPI: Raport i verifikimit të integritetit të provimeve.

## D. PERIUDHA GUSHT – SHTATOR

**14. Evidentimi i programeve që hyjnë në akreditim**

Përgjegjës: NJSBC, Fakultetet
Afati: Cdo 6 muaj ose sipas afateve ligjore per cdo program
Prodhim: Listë zyrtare + plan pune.

**15. Hartimi i raporteve të vlerësimit të brendshëm**

Përgjegjës: GVB, Fakultetet, NJSBC
Afati: sipas afateve te procesit te akreditimit
KPI: Raport 100% sipas standardeve ENQA/ASCAL.

UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA REKTORI

**17. Raporti Vjetor i NJSBC**

Përgjegjës: NJSBC
Afati: Tetor
KPI: Botim + prezantim Senat.

## IV. ASETET QË DUHEN KRIJUAR

### 1. Baza e të Dhënave Institucionale

Përfshin:

- të dhënat e studentëve,
- hyrje-dalje provimesh,
- anketat,
- indikatorët e pedagogëve,
- statistika të akreditimeve.
  KPI: funksionalitet bazë brenda 6 muajve.

### 2. Manuali i Operimeve të Cilësisë

Me procedura të qarta, të shkurtra dhe të matshme.

### 3. Procedura e Akreditimit

Kush bën çfarë + afatet.

### 4. Politika mbi funksionimin e institucionit deri në orën 21:00

(Shërbimet administrative + koordinimi i stafit).

### 5. Raporti mbi kushtet e punës së pedagogëve

Auditim i hapësirave, pajisjeve, ambienteve të përbashkëta, ngarkesës së punës.

## V. KPI-TË KRYESORE TË NJSBC

1. Pjesëmarrja e studentëve në anketa ≥ 60%
2. Zbatimi i planeve të përmirësimit ≥ 100% brenda semestrit
3. Raportim në kohë 100%
4. Reduktim i shkeljeve në provime
5. Rritja e cilësisë së syllabusave -cdo vit
6. Përgatitja e akreditimeve 100% sipas afateve
7. Rritja e kënaqësisë studentore - brenda vitit

UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA REKTORI

8. Funksionimi i shërbimeve pas orës 16:30 (auditim çdo muaj)

## VI. PËRFUNDIM

Ky plan e orienton Zyrën e Cilësisë drejt një modeli modern të menaxhimit akademik, ku:

- proceset janë të qarta,
- përgjegjësitë janë të ndara,
- të dhënat përdoren në mënyrë strategjike,
- akreditimet nuk janë ngarkesë por produkt i punës së përditshme,
- dhe ku UMT funksionon si institucion deri në orarin e plotë akademik.

UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA REKTORI

**Aneks 1**

(Pyetësorët më poshtë do të realizohen nga stafet përkatëse në fakultete dhe në bashkëpunim me anëtarët e ZCK, NJSBC dhe ekspertin e jashtëm të NJSBC)

| Kategoria | Instrumenti | Afati për implementim | Hartimi i raporteve |
|---|---|---|---|
| Vlerësimi i institucionit | Vlerësimi i institucionit nga anëtarët e personelit akademik | 11 maj- 25 maj 2026 | 31 Korrik 2026 |
| | Vlerësimi i institucionit nga anëtarët e personelit administrativ | 11 maj- 25 maj 2026 | 31 Korrik 2026 |
| | Vlerësimi i institucionit nga studentët | 11 maj- 25 maj 2026 | 31 Korrik 2026 |
| | Vlerësimi i institucionit nga studentët e vitit të parë | 17 nëntor- 30 nëntor 2025 | 31 janar 2026 |
| Vlerësimi i performancës së përgjegjësve të departamenteve | Vlerësimi i performancës së përgjegjësve të departamenteve nga stafi akademik i njësisë bazë respektive | 11 maj - 25 maj 2026 | |
| | Vetëvlerësimi i përgjegjësve të departamenteve | 11 maj - 25 maj 2026 | |
| | Vlerësimi i përgjegjësve të departamenteve nga dekanët | 25 maj - 5 qershor 2026 | |
| Vlerësimi i performancës së pedagogëve | Vlerësimi nga studentët për performancën në cdo lëndë që ata drejtojnë | 27 janar - 31 janar 2026<br>1 qershor - 15 qershor 2026 | |
| | Vlerësimi i personelit akademik nga kolegët e njësisë bazë | 11 maj - 25 maj 2026 | |
| | Vetëvlerësimi i personelit akademik | 11 maj - 25 maj 2026 | |
| | Vlerësimi i personelit akademik nga përgjegjësi i njësisë bazë | 25 maj - 5 qershor 2026 | |
| Vlerësimi i programeve të studimit | Vlerësimi i çdo lënde | 27 janar - 31 janar 2026<br>1 qershor - 15 qershor 2026 | |
| | Vlerësimi i programit të studimit nga studentët në prag diplomimi | 25 maj - 1 qershor 2026 | |